



FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Drejtuar: Operatori ekonomik "M.LEZHA" shpk

Adresa: SHKODER Zona Industriale, Rruga Levizja e Postribes, nr pasurie 11/200, zona kadastrale 8592

Procedura e prokurimit: **"Mobilim i Bibliotekave të Qytetit", të ndarë në lote:**

Loti III: Mobilim i Bibliotekës së Qytetit Nja 11"

Numri i referencës së procedurës/lotit: **Numri i referencës së procedurës/lotit Numri i referencës së lotit 3 62930-06-25-2020**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **Loti III: Mobilim i bibliotekës së qytetit nja 11"**, duke realizuar mobilimin e Bibliotekës së Qytetit nja 11, sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit.

Publikime të mëparshme: *(nëse zbatohet)*: Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini nr. 39 datë 29 Qershor 2020.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik "ERZENI/SH" shpk me nr. NUIS J66902027T

Vlera e ofertës pa TVSH = 1.976.000 (njemilion e nenteqind e shtatedhete e gjashte mije) **lekë**

2. Operatori Ekonomik "M.LEZHA" shpk, me nr. NUIS J76504013C

Vlera e ofertës pa TVSH = 1.928.200 (nje milion e nenteqind e njezet e tete mije e dyqind) **lekë**

3. Operatori Ekonomik "Buna" shpk, me nr. NUIS J61826501C

Vlera e ofertës pa TVSH = 0 (zero) **lekë**

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

- **Operatori Ekonomik “Buna” shpk**, me nr. NUIS J61826501C

Përkatësishtë për arsyet e mëposhtme:

Pas hapjes së ofertave, u konstatua se shoqëria **“BUNA” shpk** nuk ka paraqitur dokumentacionin ligjor kualifikues. Ky fakt i konstatuar u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të ofertave.

Mungesa e ofertës ekonomike dhe dokumentacioni ligjorë kualifikues u konfirmua nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53, pika 3 dhe pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar) si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu VII, Neni 66, pika 3, KVO e shpall **të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se **Operatori Ekonomik “M.LEZHA” shpk**, me nr. NUIS J76504013C, **me adresë:** SHKODER Zona Industriale, Rruga Levizja e Postribes, nr pasurie 11/200, zona kadastrale 8592, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme pa tvsh 1.928.200 (një milion e nentëqind e njetzet e tete mije e dyqind) **lekë, është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Shëtitorja “Dëshmorët e Kombit”, nr.1, 1001, Tiranë, Sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **1.976.000** (njemilion e nentëqind e shtatedhete e gjashte mije) **lekë**, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **15.07.2020**

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 pika 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, **nuk është paraqitur asnjë ankesë.**